

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEGA NË SHTËRPË, si gjykatë e shkallës së parë penale, gjyqtari Adem Shabani, me asistentin Muedin Rexhepi, në çështjen penale kundër të akuzuarve F.K., P.A., dhe G.A., që të tre nga fshati..... , Komuna Suharek, me të cilën në bashkëkryerje kryen veprën penale shkretërimi i pyjeve nga neni 357 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, sipas aktakuzës së PPK-së në Ferizaj PP/II.nr.1549-2/16 e dt.19.09.2016, në prani të përfaqësuesit të akuzës-prokurorit të shtetit Bahri Hyseni, të akuzuarëve F.K., P.A., dhe G.A., mbrojtësit të të akuzuarit P.A. av.I.H. nga dhe përfaqësuesi i DZHE-së zyra në Shtërpcë M.S. , pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datën 24.11.2016, mori dhe publikisht shpalli këtë

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1. I akuzuari F.K. nga fshati , Komuna Suharek, i lindur me datën data e lindjes... në të njejtin vend, nga i ati J.... dhe e ëma L..... e gjinisë P..... , shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, ka të kryr shkollën fillore, i gjendjes së varfër ekonomike, me numër personal të letërnjoftimit , i pa denuar deri me tani, mbrohet në liri.

2. I akuzuari P.A. nga fshati Komuna Suharek, i lindur me datën data e lindjes... , në të njejtin vend, nga i ati R... dhe e ëma E.... e gjinisë B..... , shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, babë i një fëmije, ka të kryr shkollën fillore, i gjendjes së varfër ekonomike, me numër personal të letërnjoftimit , i pa denuar deri me tani, mbrohet në liri.

3. I akuzuari G.A. nga fshati M..... Komuna Suharek, i lindur me datën data e lindjes , në të njejtin vend, nga i ati Xh.... dhe e ëma S..... e gjinisë P..... shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, ka të kryr shkollën fillore, i gjendjes së varfër ekonomike, me numër personal të letërnjoftimit i pa denuar deri me tani, mbrohet në liri

J A N Ë F A J T O R Ë

Sepse me date 16.08.2016, rreth ores 11:00, në pyllin publik, në vendin e quajtur "Bigor-Berevce", në Rajonin Ekonomiko Pyjor Sushice, së bashku me të miturit Ç.A.1, dhe Ç.A.2, janë takuar duke prerë me sharrë motorike dhe shkretuar pyllin e duke

ngarkuar drunjët, me vëllim të përgjithshëm prej 14.13 metra kub në katër traktorët të markës “Rakovic”,-

Me të cilën në bashkëkryerje kryen veprën penale shkretërimi i pyjeve nga neni 357 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 10, 17, 31, 41, 42, 43, 46, 62 par 2 nënpar 2.7 dhe 73 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPRK-së të akuzuarit i

G J Y K O N

1.Të akuzuarit **F.K.** i shqipton dënimin mr gjobë në shumë prej **400 / katërqind / Euro**, të cilin dënim me gjobë është i obliguar ta paguan në afat prej katër muajsh, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, konform nenit 46 par.2 të KPRK-së.

Në rastë se personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguan dënimin në të holla, sipas nenit 46 par.3 të KPRK-së, i njëjti dënim do t'i shndërrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet një (1) ditë burgim.

2.Të akuzuarit **P.A.** i shqipton dënimin mr gjobë në shumë prej **400 / katërqind / Euro**, të cilin dënim me gjobë është i obliguar ta paguan në afat prej katër muajsh, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, konform nenit 46 par.2 të KPRK-së.

Në rastë se personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguan dënimin në të holla, sipas nenit 46 par.3 të KPRK-së, i njëjti dënim do t'i shndërrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet një (1) ditë burgim.

3.Të akuzuarit **G.A.** i shqipton dënimin mr gjobë në shumë prej **300 / treqind / Euro**, të cilin dënim me gjobë është i obliguar ta paguan në afat prej katër muajsh, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, konform nenit 46 par.2 të KPRK-së.

Në rastë se personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguan dënimin në të holla, sipas nenit 46 par.3 të KPRK-së, i njëjti dënim do t'i shndërrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet një (1) ditë burgim.

Konform nenit 62 paragafi 2. nënpar 2.7 të KPRK-së të akuzuarëve F.K. dhe P.A. u shqiptohet *denimi plotësues* konfiskimi i masësë drurore të ngarkuara në traktorin e markës “ Rakovica 65 ” me ngjyrë të kaltërt me kabinë nr..... me rimorkio dhe në traktorin e markës “ Rakovica 65 ”, me kabinë nr. dhe rimorkio, dhe masa drurore e konfiskuar ti dorëzohet Drejtorisë së Pylltarisë në Shtërpcë, me seli në fshatin Jazhicë, Komuna e Shtërpcës.

Gjykata nuk e ka aprovuar propozimin e prokurorit të shtetit që sekuestrimi i përkohshëm i traktorëve të markës “ Rakovica 65 ” me ngjyrë të kaltërt me kabinë nr..... me rimorkio dhe traktorin e markës, me kabinë nr. dhe rimorkio, konform nenit 69 të KPRK-së të konfiskohen.

Përfaqësuesi i të dëmtuarës DZHE-së zyra në Shtërpcë, për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike është udhëzuar në kontest civil.

Obligohen të akuzuarit që në emër të paushallit gjyqësor secili veç e veç të paguaj shumën prej 20/ njëzet / Euro, në afat prej 15 ditëve nga dita kur aktgjykimi merr formën e prerë nën kërcënimin e përmbarimit të dhunëshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1549-2/16 e dt.19.09.2016 me të cilën ka ngarkuar të akuzuarit F.K., P.A., dhe G.A. që të tre nga fshati Komuna Suharek, me të cilën në bashkëkryerje kryen veprën penale shkreterimi i pyjeve nga neni 357 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së.

Gjykata duke vepruar rreth kësaj çështje penale konform nenit 245 par.1 të KPPK-së me dt.24.11.2016 ka mbajtur shqyrtimin fillestar në të cilin kanë marrë pjesë prokurori i shtetit Bahri Hyseni të akuzuarit F.K., P.A., dhe mbrojtësi i tij av.I. H. nga dhe G.A. si dhe përfaqësuesi i DZHE-së zyra në Shtërpcë M.S.

Gjyqtari individual ka konstatuar se të akuzuarit në afatin ligjor me kohë së bashku me ftesën për seancë gjyqësore, kanë pranuar edhe nga një kopje të aktakuzës.

Në fillim të shqyrtimit fillestar të akuzuarit janë udhëzuar në kuptim të nenit 246.1 të KPPK-së, pastaj gjyqtari gjykues ka çmuar se të dërguarit e të akuzuarëve janë rerspektuar, e më pas prokurori i shtetit ka lexuar aktakuzën të akuzuarëve dhe pasi që gjyqtari është bindur se të njëjtët e kanë kuptuar në tërësi aktakuzën me të cilën janë akuzuar, të njëjtëve ju ka dhënë mundësi të deklarohen mbi fajësinë apo pafajësinë e tyre lidhur me veprën penale për të cilën akuzohen dhe në sallë të gjykimit ka ndalë vetëm të akuzuarin e parë e dy të tjerët i ka larguar nga sallat dhe i ka ftuar më pas sipas radhës për tu deklaruar.

I akuzuari F.K. ka deklaruar se e ndien veten fajtorë dhe e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar dhe në vazhdim ka theksuar se është e vërtetë se me dt.16.08.2016 me traktorin e tij të markës, me rimorkio ka shkuar në pyll me fqinjët e tij për të bledhur dru të gjetura të prera dhe të thata për nevoja familare, nëndërkoh kanë vërejtur se po ofrohen policia dhe rojtarët e pyllit dhe kur ka vërejtur se

edhe fqinjët e tij që ishin së bashku kanë filluar të ikin dhe ky ka ikur dhe ka lënë traktorin e tij aty. Ka kërkuar nga gjykata që traktorin e konfiskuar përkohësisht t'ia kthejë sepse atë e ka për nevojë bujqësore ku nga konfiskimi më nuk ka mundësi që të punoj tokën dhe i ka mbetur pa punar ku jeton nga bujqësia e traktorin e ka mjetë kryesor për të punuar tokën, ka kërkuar nga gjykata që gjatë shqiptimit të sanksionit penal të ketë parasysh pranimin e fajsisë pendimin për veprën e kryer është i gjendjes jo të mirë ekonomike dhe nuk ka shkuar në pyje për shkrretërim por për marrjen e drunjëve të thata.

I akuzuari P.A. në shqyrimin fillestar, pas konsultimit me mbrojtësin e tij me autorizim av. I.H. ka deklaruar se e pranon fajsinë për veprën penale për të cilën është akuzuar se është hera e parë që kryen veprën penale, është penduar shumë për këtë veprë të kryer, dhe në vazhdim ka theksuar se është e vërtetë me fqinjët e tyre atë ditë ka shkuar në pyll dhe atë me traktor të markës "Rakovica" me rimorkio dhe për të mbledhur mbeturina drurore ku me vete nuk ka patur as sharrë motorike e as sopat dhe kanë gjetur dru të prera dhe ato dru kanë filluar të ngarkojnë në rimorkio, ka kërkuar nga gjykata që traktorin e konfiskuar të kthehet sepse më nuk do të shojë në pyll dhe se me të i kryer të gjitha punët bujqësore, dhe me shqiptimin e denimit gjykata të marrë për bazë pranimin e fajsisë dhe gjendjen jo të mirë materiale dhe pendimin për atë që ka shkuar atë ditë në pyje.

Mbrojtësi i të akuzuarit P.A. me autorizim av. I.H. nga , ka deklaruar e mbështetë në tërësi deklaratën e të mbrojturit të tij lidhur me pranimin e fajsisë pasi shifet se në pyll ka shkuar për të marrë dru për nevojë të tij familare dhe vullnetarisht është lajmruar në polici dhe ka kërkuar nga gjykata që me rastin e shqiptimit të denimit të shqiptojë një denim më të butë pasi kushtet ekonomike nuk i ka të mira, dhe se në pyll ka shkuar pa sharrë motorike dhe pa sopatë, ku si veprimtari kryesor familare e ka bujqësinë ku traktorin e ka të konfiskuar përkohësisht dhe që tre muaj ka mbetur pa punuar tokën kërkon nga gjykata që traktorin e markës Rakovica me kabinë dhe rimorkio të kthehet.

I akuzuari G.A. ka deklaruar se e ndien veten fajtorë dhe e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar dhe në vazhdim ka theksuar se me vllaun e tij Ç.... që e ngjiste traktorin kanë shkuar në pyll për të mbledhur dru të prera të thata ku me vete nuk kishte marrur as sopat e as sharrë motorike, i ka propozuar gjykatës që me rastin e shqiptimit të denimit të marrë për bazë pranimin e fajsisë gjendje jo të mirë ekonomike i është i moshës së re dhe se më nuk do të shkojë në pyje pa leje.

Gjyqtari në kuptim nën paragraf 248 par.1 nën.par.1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe par.4 të KPPRK-së, është e bindur se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajsisë, pranimin e kanë bërë vullnetarisht duke e mbështetur në provat që përmban aktakuza dhe në materialet e prezantuara nga ana e prokurorit të shtetit, pranimi i fajsisë mbështetet në

faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe në provat tjera të cilat gjinden në shkresat e lëndës siq janë: deklaratat e të pandehurëve të datës 19.08.2016, deklarata e dëshmitarit e datës 19.08.2016, kërkesa për sekuestrimin e datës 23.08.2016 urdhëresa për sekuestrim e datës 24.08.2016, fotografit që gjinden në shkresat e lëndës dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik.

Pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarve gjyqtari në kuptim të nenit 248 par.2 të KPPRK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit lidhur me pranimin e fajësisë dhe mbrojtësit të të akuzuarit.

Prokurori i shtetit Bahri Hyseni ka theksuar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarëve pasi pranimi i fajësisë është bërë konform ligjit dhe gjykata me rastin e shqiptimit të denimit të marrë për bazë pranimin e fajësisë si rrethanë letësuese.

Mbrojtësi i të akuzuarit P.A. av.I.H. nga ka deklaruar e mbështetë në tërësi deklaratën e të mbrojturit të tij lidhur me pranimimin e fajësisë pasi shifet se në pyll ka shkaur për të marrë dru për nevoja të tij familare dhe vullnetarisht është lajmruar në polici dhe ka kërkuar nga gjykata që me rastin e shqiptimit të denimit të shqiptoj një denim më të butë pasi kushtet ekonomike nuk i ka të mira, dhe se në pyll ka shkaur pa sharrë motorike dhe pa sopatë, ku si veprimtari kryesore familare e ka bujqësinë ku traktorin e ka të konfiskuar përkosisht dhe që tre muaj ka mbetur pa punuar tokën kërkon nga gjykata që traktorin e markës Rakovica me kabin dhe rimorkio ti kthehet.

Meqenëse të akuzuarit kanë pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përcaktuara me nenin 248 par.1 të KPPK-së, gjyqtari individual konform nenit 248 par 4 të KPPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e denimit (*nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimimi i fajësisë është bërë në pajtim me ligjin mundë të vazhdoj procesin me shqiptimin e denimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013*).

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarëve ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale në bashkëkryerje shkretërimi i pyjeve nga neni 357 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, ku me datë 16.08.2016, rreth orës 11:00, në pyllin publik, në vendin e quajtur "Bigor-Berevce", në Rajonin Ekonomiko Pyjor Sushice, së bashku me të miturit Ç.A.1, dhe Ç.A.2., janë takuar duke prerë me sharrë motorike dhe shkretuar pyllin e duke ngarkuar drunjët, me vëllim të përgjithshëm prej 14.13 metra kub në katër traktorët të markës "Rakovic", për të cilën veprën penale të akuzuarit janë penalisht përgjegjës, andaj edhe i shpalli fajtor dhe i caktoj secilit denim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata pos dënimit kryesor kundër të akuzuarëve u ka shqiptuar edhe denim plotësues konfiskimi i masësë drurore ku në rastin konkret sforcohet efekti i dënimit kryesor dhe për risocializimin e kryesit të veprës penale.

Gjykata vlerësoi propozimin e prokurorit të shtetit që ka cekur në aktakuzë që të akuzuarëve trakëtorët e konfiskaur përkohësisht ti konfiskohen, por pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe dëgjimit të akuzuarëve F.K. P.A. av. I.H. nga , se trakëtorët i kanë blerë për të punuar tokën- për bujqësi, ku nga konfiskimi i tyre para tre muajëve deri më tani kanë mbetur pa e punuar tokë e për të mbajtur familjet pasi i kanë siguruar të ardhurat nga bujqësia, janë të pa punë, e mos kthimi i traktorëve toka do tu mbetet pa punuar dhe jeta e tyre normale do të rrezikohet, i kanë propozuar gjykatës që t'u ktheh traktorët e sekuestruar përkohësisht, andaj gjykata duke marrë parasysh faktin se mjetet e konfiskuara-trakëtorët i kanë për punët bujqësore dhe se kanë premtuar se më nuk do të shkojnë në pyll pa leje të organeve kompetente, kushteve të rënda ekonomike që kanë të akuzuarit, nuk e aprovoj propozimin e për konfiskim dhe vendosi konform nenit 116 par.1 të KPPRK-së dhe lejoi kthimin e sendeve të sekuestruara.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK së të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, si rrethanë lehtësuese mori pranimin e fajsisë për të tre të akuzuarit, sjelljet e tyre korrekte gjatë procedurës penale, pendimin e thellë nga të akuzuarit, gjendje jo të mirë ekonomike, e në mungesë të rrethanave veqanarisht rënduese gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale për të akuzuarit dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, dhe në kuptim të të gjitha këtyre, i shqiptoi dënim me gjobë të akuzuarëve F.K. P.A. dhe G.A. si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke qenë e bindur se një dënim i tillë është në proporcion dhe raport me peshën e veprës konkrete penale, rrethanave të kryerjes si dhe personalitetin e të akuzuarëve dhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi ndëshkues në kuptim të preventivës speciale që i akuzuari të mos kryejë vepra penale si dhe në kuptim të preventivës së përgjithshme të parandalimit të kësaj vepre penale në shoqëri konform nenit 41 të KPRK-së.

Konformë nenit 463 parag.1 lidhur me par 3.të KPPK-së përfaqësuesi i të dëmturës DZHE-së zyra në Shtërpcë, për realizimin e kërkeses pasuroro-juridike është udhëzuar në kontest civil.

Konformë nenit 450 par.2.6 të KPPK-së obligohen të akuzuarit që në emër të paushallit gjyqësor secili veç e veç të paguaj shumën prej 20/ njëzet / Euro, në afat prej 15 ditëve nga dita kur aktgjykimi merr formën e prerë nën kërcënimin e përmbarimit të dhunëshëm.

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEGA NË SHTËRPCË
P nr.108/2016 me datë 24.11.2016

Asistenti

Muedin Rexhepi

Gjyqtari

Adem Shabani

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mundë të ushtrohet
ankesë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit
Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.